



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1098
Dt 07.09.2020

Në zbatim të pikës 6 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 443/005 të datës 31.03.2017, pikës IV të vendimit nr. prot. 836/005 të datës 30.05.2017, njoftimit të dekanit të FTU-së nr. prot. 1083, të datës 03.09.2018, nenit 41, pika 2, bashkëlidhur me pikën 1, paragrafi 1.2. të po këtij neni, të Ligjit të punës të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 25 dhe 28 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës, marr këtë:

VENDIM

- I. Prof. asoc. dr. Valdet Gjinovci, mësimdhënës i angazhuar në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore, i lejohet vazhdimi i marrëdhënies së rregullt të punës me Universitetin e Mitrovicës, sipas vendimit nr. prot. 443/005 të datës 31.03.2017.
- II. Vazhdimi i marrëdhënies së rregullt të punës dhe lidhja e kontratës do të bëhet për pjesën e mbetur të thirrjes, sipas vendimit nr. prot. 1404/004 të datës 10.10.2017 për zgjedhje në titullin profesor i asocuar për lëndët: Toksikologjia e ushqimit; Teknologji e paketimit dhe deponimit; Ekologjia në industrinë ushqimore; Toksikologjia e mjedisit; dhe Bazat e toksikologjisë, në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore.
- III. I përmenduri është i obliguar që t’u përmbahet dispozitave të Statutit të Përkohshëm të UMIB-it dhe legjislacionit në fuqi.
- IV. Të përmendurit i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhura personale të UMIB-it.
- V. Kontrata e punës me të përmendurin do të lidhet menjëherë pas deklarimit për pagë primare në UMIB.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Arsyetim

Prof. asoc. dr. Valdet Gjinovci, në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 443/005 të datës 31.03.2017, i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas kontratës nr. prot. 2/656 të datës 7.11.2013 dhe duke filluar nga data 1.6.2017 është kompensuar nga Universiteti i Mitrovicës vetëm për orët e mbajtura gjatë periudhës semestrale, në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm.

Prof. asoc. dr. Valdet Gjinovci, pas pezullimit të të drejtave dhe detyrave nga marrëdhënia e rregullt e punës si kryeshef ekzekutiv i AUV-it, përmes dekanit ka njoftuar dhe kërkuar kthimin në marrëdhënie të rregullt të punës me UMIB-in në pozitën e profesorit të asocuar në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore. Këshilli Drejtues në vendimin nr. 443/005 të datës 31.03.2017, në nenin 6 ka përcaktuar: 2. “Personeli akademik si në pikën 4 dhe 5 të këtij vendimi, në rast të pezullimit të drejtave dhe detyrave nga marrëdhënia e punës kur zgjidhet apo emërohet në funksione publike pas përfundimit të mandatit, ka të drejtë të kthehet te punëdhënësi brenda afatit prej pesë (5) ditësh pa pasur nevojë që t’i shpallet konkursi publik.” Gjithashtu, sipas nenit 41, pika 2, bashkëlidhur me pikën 1, paragrafi 1.2. të po këtij neni të Ligjit të punës të Republikës së Kosovës përcaktohet


se: pas pushimit të të drejtave të punës sipas paragrafit 1. të këtij neni, i punësuari ka të drejtë të kthehet te punëdhënësi brenda afatit prej pesë (5) ditësh.

Prandaj, në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues, nr. 443/005 të datës 31.03.2017, nr. prot. 836/005 të datës 30.05.2017, neni 41, pika 2, bashkëlidhur me pikën 1, paragrafi 1.2. të po këtij neni, të Ligjit të punës të Republikës së Kosovës, neni 25 dhe 28 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicë, si dhe njoftimit të dekanit të FTU-së nr. prot. 1083, të datës 03.09.2020 të parashtruar brenda afatit ligjor, rektori i Universitetit të Mitrovicës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim, në afat prej 15 ditëve të punës nga dorëzimi (në kopje fizike apo elektronike) ka të drejtë të parashtojë ankesë pranë Këshillit Drejtues të UMIB-it (neni 170 i Statutit).

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. DAP;
4. Zyrës së personelit;
5. Dekanit të FGJ-së;
6. Rektorit të UMIB-it;
7. Sekretarit të FGJ-së
8. Shërbimit financiar.

Prof. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it

